

**TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-  
JUGOSLLAVINË**

**Lënda Nr. IT-03-66-I**

**PROKURORJA E TRIBUNALIT**

**KUNDËR**

**Fatmir LIMAJT  
HARADIN BALËS  
Isak MUSLIUT  
Agim MURTEZIT**

**AKTAKUZA**

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në bazë të kompetencave të saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (tutje “Statuti i Tribunalit”) akuzon:

**Fatmir LIMAJN, i njohur si Çeliku  
Haradin BALËN, i njohur si Shala  
Isak MUSLIUN, i njohur si Qerqizi  
Agim MURTEZIN, i njohur si Murrizi**

**Për KRIME KUNDËR NJERËZIMIT dhe SHKELJE TË LIGJEVE  
OSE ZAKONEVE TË LUFTËS.**

**TË AKUZUARIT**

1. **Fatmir LIMAJ**, i njohur si Çeliku, u lind më 4 shkurt 1971 në Banjë, atëherë në komunën e Suharekës në krahinën autonome të Kosovës (“Kosovo”). Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Fatmir LIMAJ** ishte komandant në *Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës* (UÇK). Në këtë post, **Fatmir LIMAJ** ishte përgjegjës për funksionimin e Kamp-Burgut të UÇK-së në Llapushnik (më tej: Kamp-Burg i Llapushnikut”), që gjendej në komunën e Glllogocit në Kosovë.

2. **Haradin BALA**, i njohur si Shala, u lind më 10 qershor 1957 në Koreticë të Epërme në komunën e Gllogocit. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Haradin BALA** ishte anëtar i UÇK-së dhe komandant/rojë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
3. **Isak MUSLIU**, i njohur si Qerqizi, u lind më 31 tetor 1970 në Reçak në komunën e Shtimes në Kosovë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Isak MUSLIU** ishte anëtar i UÇK-së dhe komandant/rojë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
4. **Agim MURTEZI**, i njohur si Murrizi, u lind më 20 shkurt 1956 në Qylagë në komunën e Lipjanit në Kosovë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Agim MURTEZI** ishte anëtar i UÇK-së dhe rojë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.

### PARAQITJA E FAKTEVE

5. Jo më vonë se herët në vitin 1998, pas viteve të tensionit dhe dhunës që sa vinin shtoheshin, filloi konflikti i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së në Kosovë. Ky zhvillim përputhej me politikën në përgjithësi militante të UÇK-së kundër pushtetit serb në Kosovë.
6. Bashkë me civilë serbë, civilët shqiptarë që sipas UÇK-së refuzuan të bashkëpunonin me UÇK-në ose i rezistuan me mjete joluftarake u bënë objekt i kërcënimeve, burgosjes, dhunës dhe vrasjes.

### PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

7. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Fatmir LIMAJ**, në postin e përmendur më sipër, ushtroi komandë dhe kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi anëtarët e UÇK-së që drejtuan Kamp-Burgun e Llapushnikut.
8. Në postin e përmendur më sipër, **Fatmir LIMAJ** kishte kompetenca për të disiplinuar dhe për të ndëshkuar vartës që kryenin shkelje të disiplinës ushtarake ose veprime të kundërligjshme, duke përfshirë shkelje të së drejtës ndërkombëtare.
9. **Fatmir LIMAJ**, **Haradin BALA**, **Isak MUSLIU**, dhe **Agim MURTEZI** janë përgjegjës për krimet për të cilat akuzohen në këtë aktakuzë, në bazë të Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit, të

përcaktuar si më poshtë, për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen ose përndryshe për ndihmë në planifikimin, përgatitjen, ose kryerjen e veprimeve ose mosveprimeve të parashtruara në këtë aktakuzë.

10. **Fatmir LIMAJ** gjithashtu mban përgjegjësi penale për krimet për të cilat akuzohet në këtë aktakuzë si epror në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit. Kjo përgjegjësi penale përfshin përgjegjësinë e një oficeri epror për veprimet e vartësve të vet në qoftë se eprori dinte ose kishte arsye të dinte se ky vartës ishte në prag të kryerjes së veprimeve të tilla ose i kishte kryer dhe eprori nuk mori masat a duhura dhe të arsyeshme për të parandaluar veprime të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre.

### AKUZAT E PËRGJITHSHME

11. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ekzistonte një situatë konflikti të armatosur në Kosovë.
12. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e akuzuara si Krime kundër Njerëzimit ishin pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik të drejtuar kundër popullatës serbe dhe anëtarëve të popullatës civile shqiptare të cilët mendoheshin të kenë refuzuar të bashkëpunonin me UÇK-në ose ta rezistonin me mjete joushtarake.
13. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** ishin dëtyruar t'u përmbaheshin ligjeve dhe zakoneve të luftës, duke përfshirë Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollin Shtesë II.

### AKUZAT PIKAT 1 deri në 2 (BURGOSJE, TRAJTIM MIZOR)

14. Prej ose rreth majit 1998 deri në ose rreth 25 korrikut 1998, në komunat e Shtimes, Glogocit dhe Lipjanit në Kosovë, **Fatmir LIMAJ**, vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tij, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu, ose përndryshe ndihmoi planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimeve të Burgosjes dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** gjithashtu dinte ose kishte arsye që të

dinte se krimet e Burgosjes dhe Trajtimit Mizor do të kryheshin ose ishin kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk mori masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre. **Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** kryen ose përndryshe ndihmuan në kryerjen e krimeve të Burgosjes dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë.

15. Gjatë periudhës kohore të përmendur më sipër, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** zunë në mënyrë të paligjshme se paku tridhjetëepesë civilë serbë dhe shqiptarë nga komunat e Shtimes, Glllogocit dhe Lipjanit në Kosovë dhe i sollën me dhunë në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
16. Në Kamp-Burgun e Llapushnikut, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** mbajtën në mënyrë të paligjshme civilë serbë dhe shqiptarë për periudha të gjata. Të burgosurit civilë shqiptarë u pyetën vazhdimisht për gjoja “bashkëpunim” me serbë, shpesh në bazë vetëm të kontakteve joushtarake me civilë serbë. **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** morën pjesë personalisht në ruajtjen e të burgosurve në Kamp-Burgun e Llapushnikut dhe në marrjen në pyetje të të burgosurve.
17. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** morën pjesë në:

Pika 1: Burgosje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të Neneve 5(e), 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 2: Trajtim Mizor, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

### **PIKAT 3 deri në5 (TORTURË, TRAJTIM MIZOR)**

18. Prej ose rreth majit 1998 deri në ose rreth 25 korrik 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut, **Fatmir LIMAJ**, vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tij, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu, ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimeve të Torturës dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** gjithashtu dinte ose kishte arsye që të dinte se krimet e Torturës dhe Trajtimit Mizor do të kryheshin ose ishin kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk mori masa të domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar akte të tilla ose për të ndëshkuar kryesit e tyre. **Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** kryen ose përndryshe ndihmuan në kryerjen e krimeve të Torturës dhe Trajtimit Mizor të civilëve serbë dhe shqiptarë.
19. Gjatë periudhës kohore të përmundur më sipër, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** i mbajtën të burgosurit në Kamp-Burgun e Llapushnikut në kushte brutale dhe çnjerëzore, duke ushtruar ndaj tyre sulme fizike dhe psikologjike në mënyrë rutinore, duke përfshirë tortura dhe rrahje. **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** morën pjesë në imponimin dhe vazhdimin e kushteve çnjerëzore në kamp, të cilat përfshinin ushqim dhe trajtim mjekësor të pamjaftueshëm, dhe morën pjesë ose ndihmuan në torturat dhe rrahjet ndaj të burgosurve.
20. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI** morën pjesë në:

Pika 3: Torturë, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(f), 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 4: Torturë, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU** dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 5: Trajtim Mizor, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3,

7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA, Isak MUSLIU dhe Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

**PIKAT 6 deri në 7  
(VRASJE)**

21. Prej një date në ose rreth qershorit 1998 deri në 25 korrik 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT**, duke përfshirë **Haradin BALËN** dhe **Isak MUSLIUN**, planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen, ose përndryshe ndihmuan në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimit të Vrasjes së civilëve serbë dhe shqiptarë në Kamp-Burgun e Llapushnikut. Në secilin prej rasteve të parashtruar më poshtë, **Fatmir LIMAJ** dinte ose kishte arsye që të dinte se krimi i Vrasjes do të kryhej ose ishte kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk mori masa të domosdoshme dhe të aryeshme për të parandaluar akte të tilla ose të ndëshkonte kryesit e tyre.
22. Në një datë pas 24 qershorit 1998 por para 25 korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** vranë një numër të burgosurish serbë dhe shqiptarë, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën I e kësaj aktakuze, në Kamp-Burgun e Llapushnikut.
23. Në një datë në ose rreth mesit të korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** rrahën, torturuan dhe vranë një numër të burgosurish serbë dhe shqiptarë, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën II e kësaj aktakuze, në Kamp-Burgun e Llapushnikut. **Haradin BALA** dhe **Isak MUSLIU** morën pjesë ose ndihmuan në vrasjen e katër të burgosurve.
24. Në një datë në ose rreth qershorit ose korrikut 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Fatmir LIMAJT** rrahën, torturuan dhe vranë Fehmi XHEMËN, i njohur si Fehmi TAFÄ, në Kamp-Burgun e Llapushnikut. **Haradin BALA** dhe **Isak MUSLIU** morën pjesë ose ndihmuan në vrasjen e Fehmi XHEMËS, i njohur si Fehmi TAFÄ.
25. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA** dhe **Isak MUSLIU** morën pjesë në:

Pika 6: Vrasje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(a), 7(1) (**Haradin BALA** dhe **Isak MUSLIU**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 7: Vrasje, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Haradin BALA** dhe **Isak MUSLIU**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

### **PIKAT 8 deri në 9 (VRASJE)**

26. Në ose rreth 25 korrikut 1998, në malet e Berishës afër Kamp-Burgut të Llapushnikut, **Fatmir LIMAJ** vetë dhe në bashkëpunim me forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e tij, planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu, ose përndryshe ndihmoi në planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e krimit të Vrasjes së njëmbëdhjetë të burgosurve shqiptarë. **Fatmir LIMAJ** gjithashtu dinte ose kishte arsye që të dinte se krimi i Vrasjes do të kryhej ose ishte kryer nga ana e vartësve të vet, dhe nuk mori masa të domosdoshme dhe të aryeshme për të parandaluar akte të tilla ose të ndëshkonte kryesit e tyre. **Haradin BALA** dhe **Agim MURTEZI** kryen ose përndryshe ndihmuan në kryerjen e krimit të vrasjes së njëmbëdhjetë të burgosurve shqiptarë.
27. Pak para 25 korrikut 1998, forcat serbe ripushtuan rrethinën e Kamp-Burgut të Llapushnikut. Si pasojë, më 25 korrik 1998, UÇK-ja e braktisi Kamp-Burgun e Llapushnikut më 25 korrik 1998 dhe **Haradin BALA** dhe **Agim MURTEZI** detyruan rreth njëzetedy të burgosur të ecnin prej kampit në drejtim të maleve të Berishës. Gjatë rrugës, ata u takuan me **Fatmir LIMAJN**, i cili u dha urdhra **Haradin BALËS** dhe **Agim MURTEZIT**.
28. Pak më vonë, **Haradin BALA** i ndau të burgosurit në dy grupe. Një grup prej rreth nëntë të burgosurish u lirua. Grupi tjetër prej rreth trembëdhjetë të burgosurish u detyrua të shkonte në një vend të hapur në pyll. Pastaj **Haradin BALA**, **Agim MURTEZI** dhe një ushtar i tretë i UÇK-së i pushkatuan, duke vrarë njëmbëdhjetë prej të burgosurve, emrat e të cilëve jepen në Shtojcën III të kësaj aktakuze.

29. Me këto veprime dhe mosveprime, **Fatmir LIMAJ, Haradin BALA**, dhe **Agim MURTEZI** morën pjesë në:

Pika 8: Vrasje, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm sipas Neneve 5(a), 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA**, dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

Pika 9: Vrasje, SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, e përcaktuar nga Neni i Përbashkët 3(1)(a) i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3, 7(1) (**Fatmir LIMAJ, Haradin BALA**, dhe **Agim MURTEZI**) dhe 7(3) (**Fatmir LIMAJ**) të Statutit të Tribunalit.

/nënshkruar në origjinal/  
Carla Del Ponte  
Prokurore  
/Vula e Zyrës së Prokurorit/

Sot, me datën njëzetekatër janar 2003.  
Në Hagë  
Holandë



## **SHTOJCA I**

Paragrafi 22: Të burgosurit e vrarë midis 24 qershorit dhe 25 korrikut 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut

Milovan KËRSTIQ  
Miodrag KËRSTIQ  
Boban MITROVIQ  
Miroslav SHULNIQ  
Zhivorad KËRSTIQ  
Stamen GENOV  
Gjorgje ÇUK

## **SHTOJCA II**

Paragrafi 23: Të burgosurit e vrarë në mes të korrikut 1998 në Kamp-Burgun e Llapushnikut

Sinisha BLLAGOJEVIQ  
Dragan (mbiemri nuk dihet)  
Agim ADEMI  
Vesel AHMETI

### **SHTOJCA III**

Paragrafi 22: Të burgosurit e vrarë në ose rreth 25 korrikut 1998 në ose rreth maleve të Berishës afër Kamp-Burgut të Llapushnikut

Emin EMINI  
Ibush HAMZA  
Hyzri HAJRIZI  
Shaban HOTI  
Hasan HOXHA  
Safet HYSENAJ  
Mehmet OLLURI  
Bashkim RASHITI  
Hetem REXHAJ  
Lutfi XHEMSHITI  
Shyqyri ZYMERI